



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 4 korrik 2017
Nr. ref.:AGJ 1101/17

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI81/16

Parashtrues

Valdet Nikçi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 949/16,
të 20 prillit 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Valdet Nikçi, nga Peja (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 949/16, të 20 prillit 2016, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe ishte aprovuar Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë C. nr. 1022/15, të 8 shkurtit 2016, për suspendimin e procedurës në rastin e tij kontestimor.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 maj 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata)
6. Më 14 qershor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 2 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues, duke zëvendësuar gjyqtarin Robert Carolan i cili ka dhënë dorëheqje nga Gjykata më 9 shtator 2016. Kryetarja e Gjykatës caktoi edhe Arta Rama-Hajrizin gjyqtare në Kolegjin shqyrtues, duke zëvendësuar gjyqtarin Almiro Rodrigues.
8. Më 21 nëntor 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj Gjykatës së Apelit.
9. Më 1 dhjetor 2016, Gjykata e njoftoi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) për regjistrimin e kërkesës duke e ftuar që të dorëzonte komente në afat prej 7 ditësh nga pranimi i shkresës.
10. Më 12 dhjetor 2016, AKP-ja dorëzoi komentet e saj lidhur me kërkesën.
11. Më 14 dhjetor 2016 Gjykata vendosi ta shtyjë shqyrtimin e kërkesës.

12. Më 31 maj 2017 Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe gjetje të shkeljes së Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

A. Procedura fillestare

13. Parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie pune me Ndërmarrjen Shoqërore “Fabrika e Konstruksioneve Metalike” (ish-“UTVA) në Pejë (në tekstin e mëtejme: FKM), e cila pretendohet se nuk ia kishte kompensuar atij pagat mujore, për periudhën prej 1 qershorit 1995 deri më 31 mars 1997.
14. Më 27 maj 1997, parashtruesi i kërkesës, duke i përfaqësuar bashkëpunëtorët e tjerë, parashtrroi padi në Gjykatën Komunale në Pejë kundër FKM-së, duke kërkuar pagesën e pagave të tyre të papaguara.
15. Më 27 tetor 2004, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 133/03) aprovoi padinë e parashtruesit, dhe e obligoi FKM-në që t’ia paguajë pagat mujore të papaguara, prej 1 qershorit 1995 deri më 31 mars 1999. Gjykata Komunale “[...] konstatoi se kërkesëpaditë e precizuara të paditësve kanë bazë juridike e si të tilla gjykata i aprovoi si të bazuara”.
16. Më 16 shkurt 2005, AKM-ja, nëpërmjet Prokurorit Publik të Shtetit, parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, për shkak të “shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të rregullores nr. 12/2002 “Mbi themelimin e Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës”.
17. Më 22 mars 2005, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Mlc. nr. 2/2005), refuzoi, si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, me arsyetimin se, “Gjykata Komunale në Pejë ka pasur juridiksion për të vendosur për paditë në pajtim me Ligjin mbi Gjykatat e Rregullta (Nr. 21/1978) dhe se ka përcaktuar drejt faktet, dhe në mënyrë të drejtë ka aplikuar ligjin procedural dhe atë material.”
18. Përveç kësaj, Gjykata Supreme i vlerësoi argumentet e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi se “Gjykata Komunale ndër të tjera, është kompetente për të gjykuar kontestet lidhur me kërkesat pronësore juridike” (...) e paditura [FKM] ka cilësinë e personit juridik, prandaj pretendimet se ajo, si e paditur, nuk ka mundur të marrë pjesë në procedurë nuk janë të bazuara.”; (...) “Nga kjo padi (neni 29 i kësaj Rregulloreje 12/2002) kuptohet se çdo padi që do të parashtrohet pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje duhet t’u nënshtrohet rregullave të parashikuara me këtë dispozitë, por meqë paditësit padinë e kanë ngritur para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, edhe thënia në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë se aktgjykimi i goditur është marrë me cenimin e kësaj dispozite, nuk është e bazuar.”

B. Përsëritja e procedurës

19. Gjatë periudhës 2010-2014, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP-ja), pasardhësja ligjore e AKM-së, dorëzoi dy kërkesa për rishikimin e procedurave për pretendimin e parashtruesit nëpërmjet dy procedurave paralele: (A) një procedurë e parë te Kolegji i Apelit i Dhomë së Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) dhe (B) një procedurë të dytë në Gjykatën e Qarkut dhe Supreme sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore.

B1. Në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme

20. Më 10 janar 2011, AKP-ja parashtrroi në Kolegjin e Apelit kërkesë për rigjykim të rastit të Gjykatës Komunale C. nr. 133/03 (Aktgjykimi C. nr. 133/03, të 27.10.2004), në bazë të nenit 421 paragrafi 3 dhe 9 të Ligjit të RSFJ-së për Procedurën Kontestimore (LPK). AKP-ja argumentoi se Gjykata Komunale duhet të ketë refuzuar juridiksionin për të vendosur kërkesën pasi që ajo është parashtruar kundër FKM-së, një Ndërmarrje Shoqërore (NSH) nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), më vonë AKP-së.
21. Më 3 mars 2011, Kolegji i Apelit (Aktvendimi SCPL-11-0001) transferoi kërkesën për rigjykim te Trupit Gjykses të Dhomës së Posaçme, në mënyrë që ta marrë përsipër rastin nga juridiksioni i gjykatave të rregullta në pajtim me nenin 16 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2008/6.
22. Më 4 dhjetor 2013, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (pasardhësja ligjore e Trupit gjykses) refuzoi (Aktvendimi SR-11-0001) kërkesën e AKP-së për rigjykim. Kolegji i Specializuar arsyetoi se, pavarësisht nëse Gjykata Komunale kishte apo nuk kishte juridiksion për rastin në atë kohë, vendimi i Gjykatës Komunale (Aktgjykimi C. nr. 133/03, i 27.10.2004) ishte bërë i formës së prerë dhe i detyrueshëm (*res judicata*), sepse nuk ishte bërë ankesë tjetër kundër atij vendimi. Kolegji i Specializuar konsideroi se kjo ishte në kuadër të parimit të sigurisë juridike dhe përfundoi si në vijim:

“Në rastin në fjalë, [AKP-ja] nuk kishte ngritur çështjen e mungesës së juridiksionit gjatë procedurës gjyqësore në Gjykatën Komunale në Pejë dhe më tej nuk kishte parashtruar ankesë kundër aktgjyqimit të datës 27 tetor 2004, të pranuar më 16 dhjetor 2004. Në përputhje me argumentet e paraqitur më sipër lidhur me statusin ligjor të NSH-së nën administrimin e AKP-së, fakti që Gjykata Komunale nuk e ka përfshirë Agjencinë në procedurë nuk e ndryshon faktin e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

Prandaj aktgjykimi i Gjykatës Komunale nuk duhet të jetë objekt i shqyrtimi të mëtutjeshëm nga Dhoma e Posaçme”.

B2. Në Gjykatën e Qarkut dhe Supreme

23. Më 30 prill 2010, AKP-ja parashtrroi kërkesë për përsëritje të procedurës në shkallën e parë të Gjykatës e Qarkut në Pejë lidhur me rastin C. nr. 133/03 që ishte vendosur nga Gjykata Komunale më 27 tetor 2004.
24. Më 22 nëntor 2010, shkalla e parë e Gjykatës së Qarkut (Aktvendimi Ac. nr. 390/2010), hodhi poshtë kërkesën e vjetruar për përsëritjen e procedurës, pasi që kishte kaluar afati prej (5) vitesh.
25. AKP-ja parashtrroi ankesë në shkallën e dytë të Gjykatës së Qarkut, për shkak të shkeljeve të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe gabimeve dhe vlerësimit jote të plote të gjendjes faktike.
26. Më 21 mars 2011, instanca e dytë e Gjykatës së Qarkut (Aktvendimi K. Ac. nr. 4/10) prishi Aktvendimin e instancës së parë të Gjykatës së Qarkut dhe ktheu rastin në instancën e parë të Gjykatës së Qarkut për rishqyrtim dhe rivendosje. Ky Vendim specifikisht ka konsideruar se rregullsitë e vendimit të ankimuar *“nuk mund të vlerësohet rregullsia e aktvendimit të ankimuar ngase me rastin e vendosjes (instanca e pare) gjykata e Qarkut gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 196, lidhur me nenin 237.2 të LPK-se, ngase përfaqësuesi i AKP-se me propozimin lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës, pretendimet e saj ishin se me rastin e vendosjes në mënyrë meritore është bere shkelje te nenit 421 al. 3 te LPK-se, ngase ne procedure ka marr pjese si paditës ose si i paditur personi që nuk mund të jetë pale ne procedure apo palën që është personi juridik nuk e ka përfaqësuar personi 1 autorizuar. Meqenëse ky pretendim ishte ne propozim për përsëritjen e procedurës atëherë gjykata është dasht që ta vlerësoj këtë çështje”*.
27. Më 20 prill 2011, instanca e parë e Gjykatës së Qarkut (Aktvendimi AC. nr. 141/2011) anuloi Aktgjykimin fillestar (C. nr. 133/03 të 27 tetorit 2004) të Gjykatës Komunale në Pejë dhe lejoi përsëritjen e procedurës.
28. Më 3 korrik 2011, parashtruesi parashtrroi kërkesë për revizion të atij vendimi në Gjykatën Supreme *“për shkak të shkeljeve substanciale të dispozitave të LPK-së.”*
29. Parashtruesi i kërkesës pretendoi konkretisht në kërkesën për revizion se AKM-ja *“ishte njoftuar që (...) është duke u mbajtur kontesti në Gjykatën Komunale në Pejë (...). Ky njoftim është bërë më 10 maj 2004, në orën 11:20”; (...)* *“nuk ishte parashtruar asnjë ankesë kundër këtij Aktgjykimi ashtu që ky Aktgjykim është bërë i formës së prerë”; (...)* *“Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Mlc. Nr. 2/2005 të datës 22.03.2005, ka dhënë përgjigje lidhur me dyshimin (...)lidhur me atë se a është në pyetje çështja e legjitimitetit të palës së paditur apo jo dhe a janë bërë shkelje të dispozitave të nenit 29 të Rregullores së UNMIK-ul 12/2002”; ”gjykata e shkallës së parë ka vendosur për padinë kundër ndërmarrjes Fabrika e Konstruksioneve Metalike në Pejë [FMK], e jo kundër Agjencisë”*.

30. Më 3 prill 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. nr. 21/2014), hodhi poshtë, si të palejuar kërkesën e parashtruesit për revizion.

C. Rihapja dhe pezullimi i procedurës

31. Si pasojë e aprovimit të përsëritjes së procedurës nga ana e shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut, Gjykata Themelore në Pejë (pasardhësja ligjore e Gjykatës Komunale në Pejë në bazë të Ligjit të ri për Gjykatat, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2013) filloi të shqyrtojë rastin, tashmë të regjistruar në Gjykatën Themelore me numër C. nr. 254/11.
32. Më 2 qershor 2014, AKP-ja kërkoi nga Gjykata Themelore “*ndërprerjen e të gjitha procedurave (...) duke përfshirë edhe seancën e çështjes gjyqësore C. no. 254/11, të 8 korrikut 2014*”, për shkak se, sipas Ligjit 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të Kosovës, të aplikueshëm në atë kohë, çdo procedurë në lidhje me ndërmarrjet shoqërore në procedurë të likuidimit do të pezullohet.
33. Më 23 korrik 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën KI121/14 në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar, *inter alia*, shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë për shkak të vendimeve të ndryshme thelbësore të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Qarkut. Gjykata Themelore ishte njoftuar në lidhje me regjistrimin e kërkesës KI121/14.
34. Më 3 shtator 2014, Gjykata Themelore vendosi për ndërprerjen e procedurës kontestimore “*shtyhet seanca për kohë të pacaktuar ndërsa data e seancës së ardhshme do të caktohet pasi që Gjykata Kushtetuese të vendos lidhur me ligjshmërinë (sic) e aktvendimit të Gjykatës Supreme [...]*”.
35. Më 8 shtator 2015, Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, deklaroi kërkesën KI121/14 të papranueshme, sepse parashtruesi ende nuk kishte shteruar të gjitha mjetet juridike.
36. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Themelore rifilloi shqyrtimin e procedurës kontestimore.
37. Më 8 shkurt 2016, Gjykata Themelore (Aktvendimi C. nr. 1022/15) pezulloi shqyrtimin e procedurës kontestimore në rastin C. nr. 254/11 në pritje të përfundimit të procedurës së likuidimit të FKM-së. Gjykata Themelore arsyetoi si në vijim.

“Sipas dispozitave të nenit 10 par 1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parashihet se çdo veprim gjyqësor. administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshinë apo që është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj) që është subjekt i vendimit për likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit për likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit.”

(...)

Prandaj, nga arsyet e cekura me lartë e duke u bazuar në dispozitat e lartë përmendura pasi që Fabrika e Konstruksionet Metalike në Pejë, është në likuidim që nga dt. 16.11.2007, në bazë të vendimit të bordit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të dt. 01.11.2007, gjykata vendosi që ta pezulloj procedurën në këtë çështje kontesimore”.

38. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar *“shkelje thelbësore të rregullave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale”.*
39. Më 20 prill 2016, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 949/16) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe aprovoi vendimin e Gjykatës Themelore të 8 shkurtit 2016.
40. Për më tepër, Gjykata e Apelit pranoi se Aktgjykimi C. nr. 133/03 i Gjykatës Komunale, i 27 tetorit 2004, *“ishte bërë i plotfuqishëm më 28 dhjetor 2004”.* Ajo më tej pranoi se *“Me Aktvendimin Ac. nr. 141/2011, të 20 prillit 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë lejon përsëritjen e procedurës së përfunduar me aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Pejë CP. nr. 133/03, të 27 tetorit 2004, dhe anulon aktgjykimin e lartcekur”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

41. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta, përkatësisht të Gjykatës së Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 949/16), janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.
42. Parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon se Gjykata e Apelit, duke pezulluar procedurën kontestimore deri në përfundimin e likuidimit të FKM, e ka penguar në mënyrë efektive atë nga marrja ndonjëherë e një vendimi përfundimtar për kërkesën e tij.
43. Përveç kësaj, sipas fjalëve të vet parashtruesit, *“kjo procedurë është përfundimtare, ngase pas përfundimit të procedurës së likuidimit, kjo ndërmarrje nuk do të ekziston më, dhe nuk do të ketë se për çka të shqyrtohet... si thotë fjala e popullit: “Nga njeriu i vdekur nuk ka met fat”.*
44. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata *“të vlerësojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë”* e vendimeve të dhëna në rastin e tij dhe, përkatësisht *“a ka vendosur drejtë Gjykata Themelore në Pejë, [Aktvendimi C. nr. 1022/15, i 8 shkurtit 2016] kur e ka pazulluar procedurën sepse ndërmarrja është në procedurë likuidimi dhe se ndërmarrja ka qenë në procedurë likuidimi edhe në kohën kur është miratuar propozimi për përsëritjen e procedurës, dhe Gjykata e Apelit [Aktvendimi Ac. nr. 949/16, i 20 prillit 2016] kur e ka refuzuar ankesën e paditësve dhe aktvendimin e*

Gjykatës Themelore në Pejë C. nr. 1022-1015e e vërteton me aktvendimin e saj”.

45. Në fund, parashtruesi i kërkesës pretendon vendim përfundimtar për pagesën e pagave të papaguara. Vendimi i kontestuar, që pretendohet se pezullon procedurën *sine die*, e bën pagesën përfundimtare pothuajse të paarrtshme dhe e mohon të drejtën e parashtruesit të kërkesës për vendim përfundimtar.

Pranueshmëria e kërkesës

46. Gjykata i referohet nenit 46 [Lejueshmëria], i cili përcakton:

Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore.

47. Prandaj, Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

48. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], i cili përcakton:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”

(...)

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

49. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47, 48 dhe 49 të Ligjit, të cilët parashohin si në vijim:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49 [Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.

50. Gjykata më tej i referohet rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjyqimit të kundërshtuar

51. Gjykata vëren se parashtruesi e parashtrroi kërkesën më 20 maj 2016, duke kontestuar Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të 20 prillit 2016, me të cilin ishin pezulluar në kohë të pacaktuar procedurat ku ai është paditës dhe me të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat e tij për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mjete juridike.

52. Gjykata konsideron se parashtruesi është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, ka parashtruar kërkesën e tij brenda afatit të paraparë prej katër (4) muajve dhe me saktësi i ka sqaruar se cilat të drejta pretendohet t'i jenë shkelur dhe ka specifikuar se cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin ai e konteston.

53. Prandaj, Gjykata, në pajtim me nenin 46 të Ligjit, përcakton se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parashikuara me tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

54. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit është e pranueshme dhe Gjykata do të vlerësojë tani aspektet substantive juridike të kërkesës së tij.

Aspektet substantive juridike të kërkesës

55. Gjykata rikujton se parashtruesi pretendon shkelje të: (i) së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të hapur brenda kohës së arsyeshme dhe (ii) mjeteve juridike . Parashtruesi gjithashtu pretendon shkelje (iii) të së drejtës për barazi para ligjit dhe parimeve të përgjithshme të Kushtetutës.

(i) Shkelja e pretenduar e së drejtës për gjykim publik të drejtë dhe të paanshëm brenda afatit të arsyeshëm

56. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesi pretendon se Aktvendimi Ac. nr. 949/16 të Gjykatës së Apelit, të 20 prillit 2016, ka shkelur të drejtën e tij për vendim gjyqësor në kohë, duke aprovuar aktvendimin e Gjykatës Themelore për pezullimin e shqyrtimit të procedurës kontestimore deri në përfundimin e paparaparë të procedurës së likuidimit të FKM-së.

57. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit nuk specifikon një datë qoftë për periudhën e pezullimit të procedurës apo një datë të fundit që tregon përfundimin e procedurës së likuidimit të FKM-së.

58. Për më tepër, Gjykata vëren se Aktvendimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore bazohen në paragrafin 1 të nenit 10 [Pezullimi i veprimeve] të

Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Kjo dispozitë parashikon:

“1. Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit.”

59. Gjykata rikujton se më 4 dhjetor 2013, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme (Aktvendimi SR-11-0001) vendosi se kërkesa fillestare e parashtruesit për pagesën e pagave të papaguara ishte vendosur në shkallën e fundit nga Gjykata Komunale e Pejës me Aktgjykimin e saj C. nr. 133/03, të 27 tetorit 2004. Sipas Kolegjit Specializuar, ky Aktgjykim ishte përfundimtar dhe i detyrueshëm, dhe ishte bërë *res judicata*. Kolegji i Specializuar më tej konkludoi se *“Prandaj aktgjykimi i Gjykatës Komunale nuk duhet të jetë objekt i shqyrtimi të mëtutjeshëm nga Dhoma e Posaçme”*.
60. Gjykata rikujton se më 20 prill 2011, Gjykata e Qarkut (Aktvendimi AC. nr. 141/2011), vendosi ta anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 27 tetorit 2004 dhe lejoj përsëritjen e procedurës. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore rishikoi procedurën lidhur me kërkesën e parashtruesit.
61. Gjykata konsideron se përcaktimi përfundimtar për kërkesën e vjetruar të parashtruesit për pagesën e pagave të papaguara nuk ka përfunduar ende. Në fakt, procedurat kontestimore lidhur me këtë kërkesë janë rishikuar dhe më pas janë pezulluar nga Gjykata Themelore në pritje të një përfundimi të likuidimit të FKM-së. Ai pezullim ishte konfirmuar me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit.
62. Gjykata i referohet nenit 31 [Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili në paragrafin e dytë parasheh:
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet [...] brenda një afati të arsyeshëm [...].*
63. Gjykata gjithashtu rikujton paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), i cili përcakton:
- 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile [...].*
64. Gjykata thekson se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *“të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

65. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) ka interpretuar fushën e zbatimit të nenit 6 (1) të KEDNJ-së për të siguruar, të paktën, që kërkesat në lidhje me të drejtat thjesht ekonomike – siç janë kërkesat për paga, ose një e drejtë ‘në thelb ekonomike’- hyjnë në kuptimin e shprehjes “të drejtat dhe detyrimet civile”. (Shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, , Vilho Eskelin dhe të tjerët kundër Finlandës, Aktgjykimin Nr. 63235/00, i 19 prillit 2007, paragrafi 45).
66. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit për pagesën e pagave të papaguara hyn në kuadër të të “drejtave dhe detyrimeve civile” siç përcaktohet në nenin 6 (1) të KEDNJ-së dhe në nenin 31 (2) të Kushtetutës.
67. Prandaj, Gjykata konstaton se procedurat kontestimore lidhur me kërkesën e parashtruesit janë ‘drejtpërdrejt vendimtare’ për përcaktimin e të drejtës së tij civile për pagesën e pagave të papaguara, në kuptim të nenit 6 (1) të KEDNJ-së dhe nenit 31 (2) të Kushtetutës. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi GJEDNJ-së i 16 korrikut 1971, Nr. 2614/65, *Ringeisen kundër Austrisë*, paragrafi 94).
68. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit në radhë të parë ka të bëjë me pezullimin e procedurave lidhur me padinë e tij civile, të cilat kishin filluar më 27 maj 1997 dhe ishin pezulluar më 20 prill 2016, në pritje të përfundimit të likuidimit të FKM-së, pa ndonjë datë të qartë për përfundimin e tërë këtij procesi.
69. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Kushtetuta ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008.
70. Gjykata gjithashtu vëren se periudha që do të merret në shqyrtim për këto procedura ka filluar në datën kur Kushtetuta kishte hyrë në fuqi, edhe pse parashtruesi kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale në vitin 1997 dhe një vendim përfundimtar ishte nxjerrë në vitin 2004.
71. Gjykata vëren më tej se, në mënyrë të ngjashme si në GJEDNJ, Gjykata nuk ka juridiksion që të analizojë cilësinë juridike të vendimeve të gjykatave të rregullta. Megjithatë, ajo konsideron se, duke qenë se rikthimi i çështjeve për rishqyrtim urdhërohej vazhdimisht si rezultat i gabimeve të bëra më parë, përsëritja e këtyre urdhrave brenda një grupi të procedurave nxjerr në pah një mungesë në sistemin gjyqësor (Shih rastet e GJEDNJ, *Wierciszewska kundër Polonisë*, nr. 41431/98, paragrafi 46, Aktgjykimi i 25 nëntrit 2003; *Šilc kundër Sllovenisë*, (Kërkesa nr. 45936/99), Aktgjykim i 29 qershorit 2006, paragrafi 32).
72. Gjykata konsideron se procedurat në fakt kishin përfunduar, si duket në datën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Procedura të tjera gjyqësore të cilat pasuan pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës ekskluzivisht kishin të bënin me kërkesën e AKP-së për rishikimin e rastit dhe më pas për pezullimin e mëvonshëm të rastit.
73. Procedurat shtesë filluan më 30 prill 2010. Ato përfshinin procedurat në tri shkallë të ndara të Gjykatës së Qarkut, dy shkallë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës së Supreme, një shkallë të Gjykatës Supreme në revizion, inicimi i

procedurës për rishikim në Gjykatën Themelore dhe vendimi i Gjykatës së Apelit më 20 prill 2016.

74. Gjykata vëren se gjatë një periudhe prej nëntë (9) vitesh gjykatat e rregullta kishin mbajtur procedurat lidhur me instanca ndryshme dhe të ndara. Edhe pse, mbi këtë bazë, në vetvete, Gjykata konsideron se AKM/AKP dhe gjykatat e rregullta nuk kanë arritur të procedojnë rastin e parashtresit të kërkesës me vëmendje në çështjet kryesore, me kujdes në trajtimin e këtyre çështjeve dhe efektivitet në arritjen e objektivit të procedurave.
75. Gjykata rikujton se neni 1 [Statusi Ligjor] i Rregullores Nr. 2002/12 përcakton se AKM-ja *“është themeluar si një organ i pavarur në pajtim me nenin 11.2 të Kornizës Kushtetuese”*. Neni 5 [Themelimi dhe statusi ligjor] i Ligjit Nr. 03/L-067 përcakton se AKP-ja *“themelohet si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur. (...)Agjencia themelohet si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12”*.
76. Në të vërtetë, Gjykata vëren se fillimisht AKM-ja dhe, më pas, AKP-ja, në vitin 2005 dhe më 2 qershor 2014 kanë kërkuar ndërprerjen dhe/ose pezullimin e procedurës kontestimore për shkak se FKM ishte në likuidim.
77. Për më tepër, Gjykata vëren se AKM-ja nuk e ka apeluar aktgjykimin e Gjykatës Komonale C. nr. 133/03 të 27 tetorit 2004. Megjithatë, ajo e ka nxitë Prokurorin e Shtetit të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë. Një bazë për kërkesë ishte se *“Dhoma e Posaçme ka juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë”* (neni 30 i Rregullores nto. 12/2002 për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit). Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar nga Gjykata Supreme më 22 mars 2005
78. Gjykata gjithashtu vëren se, më 30 prill 2010, AKP-ja parashtroi në shkallën e parë të Gjykatës së Qarkut kërkesë për përsëritje të procedurës lidhur me rastin C. nr. 133/03 të vendosur nga Gjykata Komonale më 27 tetor 2004. Kërkesa për përsëritje është bazuar në ekzistencën e procedurës së likuidimit të kësaj NSH, e cila sipas pretendimit kishte filluar më 13 tetor 2007. Më 20 prill 2011, shkalla e parë e Gjykatës së Qarkut (Aktvendimi AC. nr. 141/2011) anuloi Aktgjykimin fillestar C nr. 133/03, të 27 tetorit 2004 të Gjykatës Komonale dhe lejoi përsëritjen e procedurës.
79. Gjykata më tej vëren që, më 10 janar 2011, AKP-ja parashtroi në Dhomën e Posaçme një kërkesë për rishikimin e procedurës lidhur me padinë e parashtresit (C nr. 133/03, të 27 tetorit 2004), duke argumentuar se Gjykata Komonale duhet të ketë refuzuar juridiksionin për të vendosur lidhur me padinë pasi çështja ishte nën juridiksionin ekskluziv të Dhomës së Posaçme, pasi që ishte paraqitur kundër FKM, një NSH. Më 4 dhjetor 2013, Kolegji i Specializuar gjeti se Aktgjykimi i Gjykatës Komonale C. nr. 133/03 i 27.10.2004 ishte bërë i formës së prerë dhe detyrues (*res judicata*). Përveç kësaj, Kolegji i Specializuar konstatoi se mungesa e ndërhyrjes procedurale të Agjencisë (AKM) në rastin C. nr. 133/03 nuk është pengesë për plotfuqishmërinë e Aktgjykimit dhe Aktgjykimi i formës së prerë në një rast në

të cilin vetëm NSH-ja ose Agjencia kanë qenë palë është aktgjykim detyruës për të dyja, NSH-në dhe Agjencinë.

80. Megjithatë, Gjykata bashkon kronologjinë e iniciativave procedurale të kryera nga AKP-ja si më poshtë.
81. Më 30 prill 2010, AKP-ja parashtroi në shkallën e parë të Gjykatës së Qarkut kërkesë për përsëritje. Më 22 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut hodhi poshtë kërkesën për përsëritje si të vjetruar. AKP-ja parashtroi ankesë. Më 21 mars 2011, shkalla e dytë e Gjykatës së Qarkut anuloi vendimin e shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut dhe e ktheu rastin për rigjykim. Më 20 prill 2011, shkalla e parë e Gjykatës së Qarkut anuloi aktgjykimin fillestar të Gjykatës Komunale dhe lejoi përsëritjen e procedurës. Parashtruesi ushtroi revizion. Më 3 prill 2014, Gjykata Supreme e refuzoi revizionin.
82. Më 10 janar 2011, AKP-ja parashtroi në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme kërkesë për rigjykim të rastit të Gjykatës Komunale. Më 4 dhjetor 2013, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme e refuzoi kërkesën e PAK-ut.
83. Para këtyre dy grupeve të fakteve, Gjykata vëren se AKP-ja parashtroi kërkesën e saj në Gjykatën e Qarkut më 30 prill 2010; kërkesë e ngjashme është parashtruar në Dhomën e Posaçme më 10 janar 2011. AKP-ja mori vendim për kërkesën e saj të parashtruar në Gjykatën e Qarkut më 3 prill 2014; një vendim për kërkesën e saj parashtruar në Dhomën e Posaçme u mor më 4 dhjetor 2013.
84. Gjykata konkludon se, të paktën ndërmjet 10 janarit 2011 dhe 4 dhjetorit 2013, AKP-ja ishte duke vepruar njëkohësisht me Gjykatën e Qarkut dhe Gjykatën Supreme, në një anë, dhe me Dhomën e Posaçme, në anën tjetër.
85. Gjykata konsideron se sjellja e AKP-së nuk i ka kontribuar qartësisë, transparencës, dhe efikasitetit dhe efektivitetit të rastit.
86. Përveç kësaj, Gjykata vëren se, deri në prill të vitit 2014, Gjykata Themelore filloi të shqyrtojë çështjen e sapo rihapur. Megjithatë, më 2 qershor 2014, AKP-ja kërkoi pezullimin e procedurës. Më 8 shkurt 2016, Gjykata Themelore pezulloi çështjen në pritje të përfundimit të procedurës së likuidimit të FKM-së. Siç u tha më lartë, Gjykata Themelore e bazoi vendimin e saj në nenin 10, paragrafi 1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë e Privatizimit të Kosovës nr. 04/L-034 dhe se ai vendim u vërtetua më 20 prill 2016 nga Gjykata e Apelit.
87. Gjykata konsideron se AKM/AKP me këmbëngulje zbatoi disa sjellje procedurale kontradiktore, ambivalente dhe të parregullta, nga njëra anë, duke kërkuar përsëritjen e procedurës pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për shkak se procedura e likuidimit kishte filluar dhe lënda ishte në kompetencë ekskluzive të Dhomës së Posaçme; dhe, në anën tjetër, duke kërkuar përsëritjen e procedurës pranë gjykatave të rregullta, sepse procedura e likuidimit ishte në vazhdim dhe objekti i çështjes ishte gjithashtu (tani jo më kompetencë ekskluzive e Dhomës së Posaçme) në kompetencë të gjykatave të

rregullta. Vetëm pasi të ketë fituar përsëritjen e procedurës, AKP-ja kërkoi pezullimin e rastit derisa të përfundojë procedura e likuidimit.

88. Gjykata rikujton edhe një herë se parashtruesi i kërkesës pretendon se me pezullimin e papërcaktuar të procedurës, Gjykata e Apelit ia pamundësoi atij që të marrë një vendim përfundimtar për kërkesën e tij lidhur me pagat e papaguara.
89. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme (Rev. 21/2014) pranoi faktin se *“me Aktvendimin Ac. nr. 141/2011, të 20 prillit 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë lejon përsëritjen e procedurës së përfunduar me aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Pejë C. nr. 133/03, të 27 tetorit 2004”*.
90. Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata e Apelit (Ac. nr. 949/16) pranoi se: *“Me kërkesën e AKM të dt.06. korrik 2004 drejtuar kryetarit e Gjykatës Komunale, ishte kërkuar që të pushohet procesi gjyqësor pasi për këtë çështje ishte e kompetencës Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës”; (...)*“Ky Aktgjykim [C. nr. 133/2003, i Gjykatës Komunale në Pejë, i 27 tetorit 2004] kishte marr formën e prere më dt.28.12.2004. (...) “Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme me aktvendimin SR-11-0001 kishte marr vendim që sugjerimi për tërheqjen e lëndës C. nr. 133/03 nga Gjykata Komunale në Pejë për Dhomën e Posaçme është refuzuar.”; (...) “Me dt. 27 Qershor 2011, AKP përsëri kishte parashtruar kërkesë për ndërprerjen e procedurës gjyqësore në këtë çështje, për shkak se ndërmarrja gjendet në procesin e likuidimit.”*”*.
91. Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta qartazi kishin injoruar dhe shpërfillur në thelb Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar të Gjykatës Supreme të 4 dhjetorit 2013 dhe aspekte të tjera të fakteve dhe të ligjit të cilat ishin të rëndësishme për vendimet e tyre efektive.
92. Gjykata merr parasysh se GJEDNJ-ja ka pasur parasysh parimin e administrimit të duhur të drejtësisë, përkatësisht, se gjykatat e rregullta kanë për detyrë të merren siç duhet me rastet para tyre. (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ, *Boddaert kundër Belgjikës*, numër 65/1991/317/389, Aktgjykim i 12 tetor 1992, para. 39).
93. Gjykata rikujton se GJEDNJ përsëriti se *“Shtetet Kontraktuese duhet të organizojnë sistemet e tyre juridike në një mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të garantojnë të drejtën e secilit për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile brenda një kohë të arsyeshme”* (Shih rastin e GJEDNJ Nr. 53176/99, Aktgjykimin e 4 shtatorit të vitit 2002, *Mikulić kundër Kroacisë*, § 45).
94. Për më tepër, Gjykata përsërit se e drejta për gjykatë e garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së gjithashtu mbron zbatimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare, të detyrueshme, të cilat, në shtetet që pranojnë sundimin e ligjit, nuk mund të jenë të paefektshme në dëm të njëjës palë (Shih, *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së *Hornsby kundër Greqisë*, kërkesa nr. 18357/91, Aktgjykimi i 19

marsit 1997, § 40). Prandaj, ekzekutimi i një vendimi gjyqësor nuk mund të shtyhet pa arsye.

95. Gjykata gjithashtu përkujton që GJEDNJ-ja pranoi që “një pezullim i ekzekutimit të një vendimi gjyqësor për një periudhë të tillë siç është e domosdoshme për të mundësuar gjetjen e një zgjidhjeje të kënaqshme (...) mund të justifikohet në rrethana të jashtëzakonshme” (Shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, rasti *Immobiliare kundër Italisë*, kërkesa nr. 22774/93, Aktgjykimi i 28 korrikut 1999, § 69).
96. GJEDNJ-ja konkludoi se “ndërkohë që mund të pranohet që Shtetet Kontraktuese (...) ndërhyjnë në procedurat për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor, pasoja e një ndërhyrjeje të tillë nuk duhet të jetë që përmbarimi të parandalohet, shfuqizohet ose vonohet pa arsye ose, edhe më pak, që substanca e vendimit të dëmtohet” (Shih *Immobiliare kundër Italisë*, *Ibidem*, § 74).
97. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se AKM/AKP mori iniciativën dhe gjykatat e rregullta nxorën vendimet e tyre për përsëritjen dhe pezullimin e procedurës në bazë të ligjeve të aplikueshme në lidhje me likuidimin e FKM si NSH. Megjithatë, gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh aspektet ligjore dhe faktike të cilat janë bërë pjesë e historisë së rastit, edhe pse gjykatat e rregullta ishin të vetëdijshme për to, dhe të cilat ishin potencialisht në gjendje ta çojnë çështjen në fund.
98. Për më tepër, Gjykata vëren se, që nga data kur Kushtetuta hyri në fuqi, vendimi për padinë e parashtruesit të kërkesës për pagat e papaguara tanimë kishte qenë në pritje për nëntë vite pa ndonjë vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën e parashtruesit. Kështu, rasti vazhdon pas tërë kësaj periudhe, por kryesisht vazhdon *sine die*.
99. Në të vërtetë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është privuar nga e drejta e tij sipas nenit 6 (1) të Konventës që kërkesa e tij për pagesën e pagave të papaguara, të vendoset përfundimisht nga një gjykatë.
100. Gjykata më tej konsideron se kjo situatë është e papajtueshme me parimin e sundimit të ligjit.
101. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.

(ii) Pretendimet për shkelje të së drejtës për mjete juridike

102. Gjykata rikujton se parashtruesi gjithashtu pretendoi shkelje të së drejtës së tij për mjete juridike sipas nenit 32 të Kushtetutës. Megjithatë, parashtruesi nuk shpjegon si dhe pse vendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ka shkelur një të drejtë të tillë.
103. Në lidhje me këtë Gjykata i referohet nenit 32 [E drejta në Mjete Juridike] të Kushtetutës, që parasheh:

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

104. Gjykata i referohet gjithashtu nenit 13 [E drejta në mjete juridike] të KEDNJ-së që parasheh:

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

105. Gjykata konsideron se parashtruesi ankohet në Gjykatën Kushtetuese sepse është shkelur e drejta e tij për një vendim gjyqësor përfundimtar brenda një kohe të arsyeshme: ai nuk ankohet për shkak se nuk kishte asnjë mjet juridik në dispozicion për të siguruar të drejtën e tij për një vendim përfundimtar brenda një kohe të arsyeshme.
106. Në të vërtetë, Gjykata e konsideroi kërkesën e tij të pranueshme pikërisht për shkak se ai ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Në të vërtetë, Gjykata është e vetëdijshme që sistemi juridik i Kosovës nuk parasheh mjete juridike për të përshpejtuar procedurat para autoriteteve publike, duke përfshirë edhe gjykatat e rregullta, dhe për të siguruar një vendim përfundimtar në kohën e duhur. Prandaj, Gjykata konsideron se në këto rrethana, vetë Gjykata Kushtetuese është mjeti juridik i vetëm i parashtruesit të kërkesës për të siguruar të drejtën e tij për një vendim përfundimtar në kohë të duhur.
107. Gjykata rikujton se GJEDNJ konsideroi se “*edhe pse për momentin nuk ka asnjë model që mbizotëron në rendet juridike të Shteteve Kontraktuese lidhur me mjetet për tejzgjatjen e procedurave, ka shembuj që dalin nga vetë praktika gjyqësore e Gjykatës për rregullin e shterimit të mjeteve të brendshme të cila tregojnë se nuk është e pamundur që të krijohen mjete të tilla dhe të veprohet me to në mënyrë efektive (Shih, për shembull, Gonzalez Marin kundër Spanjës (dec.), nr. 39521/98., GJEDNJ 1999 deri në VII, dhe Tomé Mota kundër Portugalisë (dec.), nr. 32082/96, GJEDNJ 1999 deri në IX)” (Shih rastin e GJEDNJ Kudla kundër Polonisë, nr. 30210/96, Aktgjykim i 26 tetorit 2000, § 154).*
108. Në rastin e njëjtë, GJEDNJ konsideroi më tej se, nëse neni 13 “*interpretohet sikur të mos ketë zbatim për të drejtën për një shqyrtim brenda një kohe të arsyeshme, siç garantohet me nenin 6 § 1, individët në mënyrë sistematike do të jenë të detyruar që referojnë ankesat në Gjykatën në Strasburg, të cilat përndryshe, dhe sipas mendimit të Gjykatës, në mënyrë më të përshtatshme, duhet të adresohen në radhë të parë në kuadër të sistemit juridik kombëtar”.* (Kudla kundër Polonisë, Ibidem, § 155).
109. Gjykata konsideron, pasi që GJEDNJ gjithashtu konsideroi se “*interpretimi i drejtë i nenit 13 është që kjo dispozitë garanton një mjet efektiv pranë një autoriteti kombëtar për një shkelje të pretenduar të kriterit në bazë të nenit 6*

§ 1 për të shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme” (Kudla kundër Polonisë, Ibidem, § 156).

110. Prandaj, duke pasur parasysh nevojën që sistemi juridik i Kosovës të parasheh mjete juridike që sigurojnë vendime në kohë, Gjykata, në këto rrethana nuk konstaton shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.

(iii) Pretendimet për shkelje të së drejtës për barazi para ligjit dhe parimeve të përgjithshme të Kushtetutës.

111. Gjykata tashmë ka gjetur shkelje të nenit 31 (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.
112. Prandaj, Gjykata konsideron që nuk është nevojshme që të shqyrtojnë ankesat tjera të parashtruesit në bazë të neneve 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

Përfundim

113. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka konfirmuar pezullimin për kohë të pacaktuar të procedurës *sine die*. Prandaj, Gjykata konsideron se pezullimi i pacaktuar i procedurës që e privon parashtruesin e kërkesës nga një vendim përfundimtar lidhur me kërkesën e tij për pagimin e pagave të papaguara. Prandaj, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31 (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.
114. Gjykata gjithashtu konstaton se në rrethanat e rastit nuk ka pasur shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.
115. Gjykata më tej konstaton se nuk është e nevojshme të shqyrtohen ankesat tjera të parashtruesit të kërkesës sipas neneve 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 31 maj 2017

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË DEKLAROJË, me shumicë votash, se ka pasur shkelje të nenit 31(2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TA DEKLAROJË të pavlefshëm Vendimin Ac. nr. 949/16 të Gjykatës së Apelit të 20 prillit 2016, në pajtim me rregullin 74 të Rregullores së punës.
- IV. TA KTHEJË Vendimin Ac. nr. 949/16 në Gjykatën e Apelit për rishqyrtim në pajtim me këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të rregullit 74 të Rregullores së punës.
- V. TË KËRKOJË nga Gjykata e Apelit që ta informojë Gjykatën Kushtetuese sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më larg se gjashtë (6) muaj, në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimit të kësaj gjykate, në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës së Gjykatës.
- VI. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- VII. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit.
- VIII. TE DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.
- IX. T'UA DËRGOJË nga një kopje të këtij aktgjykimi Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Qeverisë për informatë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi